



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIM I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

A.nr. 352/2019

Zylqyfli Bajçinca dhe të tjerët

kundër

Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A.

*lidhur me moszbatimin e Aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë CP.nr.3086/16, i datës 8 qershor 2018, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me Aktvendim AC.nr.3208/18, i datës 12 nëntor 2018.*

Drejtuar: Z. George Karagutoff, Drejtor i Përgjithshëm  
Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A.

Kopje: Znj. Duda Balje, Kryetare  
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore; për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Znj. Afërdita Bytyçi, Kryetare  
Gjykata Themelore në Prishtinë

Z. Valdrin Lluka, Ministër  
Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Prishtinë, më 6 maj 2019

## Qëllimi i raportit

1. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. Zylqyfli Bajçincës dhe të tjerëve (në tekstin e mëtejme *ankuesit*) dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesve, si dhe në shkresat e lëndës, të cilat i ka Avokati i Popullit, lidhur me moszbatimin e Aktvendimit të formës së prerë CP.nr.3086/2016, i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë.
2. Qëllimi i këtij raporti është të tërheqë vëmendjen e Kompanisë Kosovare për Distribucion dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (në tekstin e mëtejme KEDS) lidhur me nevojën për ndërmarjen e veprimeve përkatëse për zbatimin, pa vonesa të mëtutjeshme, të Aktvendimit të formës së prerë CP.nr.3086/2016, i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

## Baza ligjore

Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime (...) me iniciativën e vet (*ex officio*), nëse (...) ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.” (Neni 16, par. 4).
- “Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor.” (Neni 16, par. 8).
- “të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre.” (Neni 18, par. 1, nënpar.1).
- “të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelini të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet për qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 2).
- “të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpyjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 4).
- “të njoftoj Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).
- “të rekomandoj nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).
- “të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).

- “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon t’i kryejë këto përgjegjësi ligjore.

### **Përshkrimi i rastit**

Në bazë të dokumentacionit dhe informatave të cilat i ka Avokati i Popullit, faktet mund të përmbliidhen si në vijim:

3. Më 27 shtator 2016, ankuesit kishin pranuar njoftimin dhe vendimin për ndërprerjen e kontratës së punës nga punëdhënësi i tyre KEDS në Prishtinë.
4. Më 29 shtator 2016, Federata e Sindikatave të Pavarura Elektrokosova, në emër të ankuesve të larguar nga puna, ka parashtruar ankesë (Nr. 37-00194/16-A) në Inspektoratin e Punës kundër vendimeve për ndërprerje të kontratave të punës nga ana e KEDS-it.
5. Më 26 tetor 2016, Inspektorati i Punës ka nxjerrë vendim, sipas të cilit, ankesa (Nr. 37-00194/16-A) e Federatës së Sindikatave të Pavarura Elektrokosova, e dorëzuar në Inspektoratin e Punës më 29 shtator 2016, është e bazuar dhe është obliguar punëdhënësi KEDS, me seli në Prishtinë, që në afat prej tetë ditësh t’i shfuqizojë vendimet për ndërprerje të marrëdhënies së punës për ankuesit e larguar nga puna.
6. Brenda afatit ligjor, KEDS-i ka ushtruar ankesë në Trupën Ekzekutive të Inspektoratit të Punës kundër vendimit (Nr. 37-00194/16-A) të Inspektoratit të Punës.
7. Më 2 dhjetor 2016, Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës ka nxjerrë vendim (Nr. 156/2016), me të cilin e ka refuzuar ankesën e KEDS-it dhe e ka vërtetuar vendimin (Nr. 37-00194/16-A) e Inspektoratit të Punës.
8. Më 28 dhjetor 2016, KEDS-i, në Gjykatën Themelore në Prishtinë (GjThP) - Departamenti për Çështje Administrative, ka parashtruar padi (A.nr.2034/16) për konflikt administrativ kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjegjësisht kundër Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës (MPMS-TEIP), me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit (Nr. 156/2016) të MPMS-TEIP-së, i datës 2 dhjetor 2016, si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të lartpërmendur.
9. Më 30 dhjetor 2016, GjThP-Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendim (A.nr.2034/2016) e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit - propozuesit KEDS për shtyrje të ekzekutimit të vendimit.
10. Brenda afatit ligjor, paditësi - propozuesi KEDS ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit (GjA) kundër aktvendimit (A.nr.2034/2016) të GjThP-së.
11. Më 30 dhjetor 2016, Inspektorati i Punës ka nxjerrë vendim (Nr.37/00194/16-A) për shqiptimin e masës ndëshkuese për KEDS-in, për shkak të moszbatimit të vendimit (Nr. 37-00194/16-A).
12. Më 16 shkurt 2017, GjA-ja ka nxjerrë aktvendim me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit - propozuesit KEDS, lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit (Nr.37-00194/16-A) dhe e ka vërtetuar aktvendimin (A.nr.2034/2016) e GjThP-Departamenti për Çështje Administrative, i datës 30 dhjetor 2016.

13. Më 16 shkurt 2017, sipas propozimit për përmbarim i Federatës së Sindikatave të Pavarura Elektrokosova, në emër të ankuesve, dhe në bazë të dokumentit përmbarues - Vendimit të Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës (Nr. 37-00194/2016-A), i datës 26 tetor 2016, GjThP-ja ka nxjerrë aktvendim (CP.nr.3086/16), me të cilin e ka caktuar përmbarimin kundër debitorit KEDS dhe e ka detyruar debitorin që t'i shfuqizojë vendimet për ndërprerje të marrëdhënies së punës për kreditorët.
14. Më 2 mars 2017, debitori ka parashtruar prapësim në GjThP kundër aktvendimit (CP.nr.3086/16) të datës 16 shkurt 2017.
15. Më 26 maj 2017, GjThP-ja ka nxjerrë aktvendim (CP.nr.3086/16) me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit.
16. Debitori KEDS, brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë në GjA kundër aktvendimit (CP.nr.3086/16) të GjThP-së.
17. Më 22 nëntor 2017, GjA-ja e ka nxjerrë aktvendim (Ac.nr.2935/17), me të cilin është aprovuar si e themeltë ankesa e debitorit KEDS dhe është anuluar aktvendimi (CP.nr.3086/16) i GjThP-së, i datës 26 maj 2017, si dhe çështja i është kthyer së njëjtës gjykatë për procedim të serishëm.
18. Më 8 qershor 2018, GjThP-ja ka nxjerrë aktvendim (CP.nr.3086/16), me të cilin është aprovuar pjesërisht prapësimi i debitorit të përmbarimit.
19. Brenda afatit ligjor, debitori KEDS ka parashtruar ankesë në GjA kundër aktvendimit (CP.nr. 3086/16) të GjThP-së.
20. Më 12 nëntor 2018, GjA-ja ka nxjerrë aktvendim (AC.nr.3208/18), me të cilin e ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e debitorit KEDS dhe e ka vërtetuar aktvendimin (CP.nr. 3086/16) e GjThP-së.
21. Më 20 dhjetor 2018, GjThP-ja ka lëshuar urdhër për përmbarim të aktvendimit (CP.nr. 3086/16) të GjThP-së dhe i ka kërkuar KEDS-it që, brenda tri ditëve, ta njoftojë gjykatën se ka vepruar sipas këtij urdhri.

### **Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës**

22. Neni 7 i Kushtetutës [Vlerat], paragrafi a përcakton: *“Rendi Kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mos diskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.”*
23. Neni 31 i Kushtetutës [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafi 1, përcakton: *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
24. Neni 54 i Kushtetutës [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] përcakton: *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”*
25. Neni 22 i Kushtetutës, ku janë të radhitura instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut: *“Zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”* Në mesin e këtyre instrumenteve ndërkombëtare, Avokati i Popullit veçon Konventën

Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj (KEDNj).

26. Neni 53 i Kushtetutës përcakton: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
27. Neni 6 i KEDNj-së [E drejta në një proces të rregullt], paragrafi 1, përcakton: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.”*
28. Neni 13 i KEDNj-së përcakton: *“Çdo njeri, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë për mjetet ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtar, pavarësisht se shkelja mund të jetë bërë nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”*
29. Ligji nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, në nenin 2, paragrafi a, përcakton:

*“Inspektorati i Punës si trup Ekzekutiv i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë.”*

Dhe në nenin 6, paragrafi 6.4, përcakton:

*“Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.”*

30. Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, në nenin 22, paragrafi 1.2, *parasheh vendimin përmbartues në procedurë administrative si dokument përmbartues.* Neni 23, paragrafi 2, përcakton: *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike.”* Neni 24, paragrafi 3, përcakton: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.”*

### **Analiza dhe vlerësimi i Avokatit të Popullit**

31. Vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit lidhur me këtë çështje bazohen në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet, me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të dhe Protokollat e saj, si dhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
32. Ligji nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, e përcakton Inspektoratin e Punës si organ të pavarur të administratës shtetërore, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, si të vetmin organ në kuadër të pushtetit ekzekutiv të Republikës së Kosovës, për monitorimin e zbatimit të legjislacionit nga fusha e marrëdhënies së punës, në mënyrë gjithëpërfshirëse, të sigurisë dhe të shëndetit në punë. Prandaj, të gjitha vendimet që dalin nga ky institucion lidhur me çështjet nën juridiksionin e tij, prodhojnë efekte juridike për institucionet tjera përkatëse.

33. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit thekson se ekzekutimi i një vendimi të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm administrativ duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e pandarë e një ‘grykimi’ për qëllime të së drejtës për një gjykim të paanshëm dhe duhet të zbatohet brenda një periudhe kohore të arsyeshme. Ky detyrim i takon shtetit dhe zvarritja e tepruar në zbatimin e vendimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm, apo mosndërmarrja e masave për ta zbatuar atë, përbëjnë shkelje të së drejtës për një gjykim të paanshëm dhe të së drejtës për një zhdëmtim të efektshëm.
34. Avokati i Popullit rikujton se KEDS-i vepron si person juridik, i cili merret me shpërndarjen dhe shitjen të energjisë elektrike në Kosovë, e cila, si kompani private, ushtron një autorizim publik në Republikën e Kosovës dhe e cila obligohet t’i zbatojë ligjet në fuqi.
35. Avokati i Popullit thekson se, pavarësisht se Inspektorati i Punës ka nxjerrë vendim, i cili është bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, me të cilin e ka obliguar KEDS-in që, në afat prej tetë ditësh, t’i shfuqizojë vendimet për ndërprerje të marrëdhënies së punës për ankuesit e larguar nga puna, ky vendim nuk është zbatuar nga KEDS-i.
36. Meqenëse vendimi i Inspektoratit të Punës nuk është zbatuar në mënyrë vullnetare nga KEDS-i, ankuesit i janë drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP) me propozim për përmbarim të vendimit të Inspektoratit të Punës dhe, në bazë të propozimit të tyre, gjykata ka nxjerrë aktvendim të formës së prerë, i cili po ashtu vazhdon të mos zbatohet.
37. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit thekson se do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi ligjor do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet i paefektshëm në dëm të ankuesve. Prandaj, moszbatimi i vendimeve gjyqësore prodhon efekte, të cilat sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, parim të cilin autoritetet e Republikës së Kosovës janë të obliguara ta respektojnë.<sup>1</sup>
38. Të drejtat lidhur me gjykimin e paanshëm do të mbeteshin vetëm një iluzion nëse vendimi përfundimtar i një gjykate apo tribunali, duke përfshirë vendimet administrative, nuk do të lejoheshin të ekzekutohen (*Czernin kundër Republikës Çeke*).<sup>2</sup>
39. Përveç rasteve të zvarritjes së procedurës gjyqësore, GjEDNJ-ja ka konstatuar se zvarritja e ekzekutimit të një vendimi pasi që është marrë, mundet gjithashtu të paraqesë shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së. Për shembull, GjEDNJ-ja ka konstatuar: “*E drejta për gjykim e garantuar me nenin 6, do të ishte iluzore, nëse sistemi ligjor i një shteti do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar dhe i plotfuqishëm të mbetet i paefektshëm, në dëm të një pale*”. Gjithashtu ka konstatuar: “*Qasja efektive në gjykatë përfshin të drejtën që një vendim gjyqësor të ekzekutohet pa vonesa të paarsyeshme*”.<sup>3</sup>
40. Avokati i Popullit rikujton se autoritetet kompetente kanë obligim pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor, e edhe në atë praktik, i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme (shih, *Pecevi kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008*).

<sup>1</sup> Neni 7, paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe shih rastin e GjEDNJ-së, *Romashov kundër Ukraines*, nr. 67534/01, Aktgjykimi i 25 korrikut 2004).

<sup>2</sup> Komunikata e KEDNJ-së 823/1998, KB Dok CCPR/C/83/D/823/1998 (2005), paragrafi 7.5.

<sup>3</sup> Shih Yuriy Nikolayevich Ivanov v. Ukraine, GJEDNJ, Aplikimi Nr.40450/04, 15 tetor 2009, par. 51, duke cituar *Hornsby v. Greece*, GJEDNJ, Aplikimi Nr.18357/91, 19 mars 1997, par. 40 dhe *immobiliare saffi v. Italy*, Aplikimi Nr.22774/93, par. 66

41. Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë lidhur me palët kontestuese, të cilat nuk kanë mjet të efektshëm juridik, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit vendor ligjor (shih aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999).
42. Avokati i Popullit vlerëson se *mjeti i efektshëm juridik*, në pikëpamje të nenit 13 të KEDNj-së, do të duhej të jetë në gjendje ta parandalojë shkeljen e pretenduar apo vazhdimin e të njëjtit.
43. Avokati i Popullit thekson se e drejta për mjete efektive ligjore është e garantuar me Kushtetutë dhe me ligje vendore, prandaj kjo e drejtë duhet të zbatohet praktikisht dhe të respektohet nga të gjithë, përfshirë edhe KEDS-in.

### Konstatime

44. Në bazë të vlerësimit të mësipërm, Avokati i Popullit konstaton se moszbatimi i aktvendimit të formës së prerë të gjykatës paraqet shkelje të të drejtave të njeriut/të ankuesve, lidhur me të drejtën për mjete efektive, të garantuara me aktet ligjore të lartpërmendura, pasi KEDS-i e ka zvarritur ekzekutimin e lëndës së ankuesve, procedurat e së cilës janë iniciuar qysh prej 29 shtatorit 2016 dhe ende nuk janë vendosur përfundimisht deri në ditën e nxjerrjes së këtij raporti.
45. Avokati i Popullit konstaton se zvarritja e tepruar dhe pa një zbatim të vendimit përkatës është në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor brenda një afati kohor të arsyeshëm, i garantuar me nenet 31 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenet 6 dhe 13 të KEDNj-së.

Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës e dhe organeve të tjera shtetërore*”; dhe me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit për Avokatin e Popullit: “*Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut*”; bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, i

### REKOMANDON

Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS Sh.A. që:

- **Të ndërmarrë veprime të menjëhershme për zbatimin e aktvendimit (CP.nr.3086/16) të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i datës 8 qershor 2018, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktvendimin AC.nr.3208/18, i datës 12 nëntor 2018, për rastin Zylqyfli Bajçinca dhe të tjerët.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit për

Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,



Hilmi Jashari

Avokat i Popullit